



# ZERI I POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Viti i 43-të i botimit  
Nr. 90 (11.460)

E hënë, 15 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

**Emri dhe vepra e shokut Enver,  
arkitektit të Shqipërisë së re  
socialiste, rron e do të rrojë  
në shekuj.**

## DHIMBJE E NDERIM I PAKUFISHEM PËR SHOKUN ENVER HOXHA

### SHOKU RAMIZ ALIA DHE SHOKE TE TJERE BENE HOMAZHE PRANE ARKIVOLIT ME TRUPIN E SHOKUT ENVER HOXHA



Dje paradite, shoku Ramiz Alia, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, anëtarë të Byrosë Politike dhe shoqja Nexhmije Hoxha bënë homazhe pranë arkivolit me trupin e shokut Enver Hoxha.

Caste solemne dhe mjaft pre-kese. Me dhimbje të thellë, shoku Ramiz Alia thotë:

«Shoku Enver, Ti e krijove Partinë, e bërë të fortë dhe Partia do të rrojë gjithmonë, duke ju pasur Juve në me-

ndje e në zemër. Kemi ardhur këtu sot të japim medaljen përkujtimore të 40-vjetorit të Partisë. Ta kesh me vete. Ashtu siç do të rrojë Partia, duke ju pasur Juve në mendje e në zemër, le të jetë gjithmonë Partia edhe me Juve».

Pastaj shoku Ramiz Alia vendos medaljen e lartë mbi trupin e shokut, Udhëheqësit dhe mësuesit tonë të dashur Enver Hoxha.

Arkivolit i afrohet e emocionuar shoqja Nexhmije Hoxha, dhe duke vendosur një flamur kom-

bëtar mbi trupin e shokut të saj të shtrenjtë të jetës, të luftës e të punës, thotë: «Enver, po të vë këtë flamur në zemër nga ana e kosovarëve, sepse ashtu siç i kishte Ti ata në zemër, gjithë kosovarët dhe shqiptarët e tjerë, ashtu edhe ata të kanë Ty. Kam marrë me qindra telegrame dhe prandaj, besoj se plotësoj një dëshirë të tyre. Merre edhe këtë me vete».

Pastaj ata nderojnë me grush-tin lart kujtimin e paharruar të shokut Enver.

(ATSH)

### VEPRA E SHOKUT ENVER ESHTË SKALITUR NË FLAMURIN E PARTISE, NË ZEMRËN E POPULLIT

— NGA LETRAT E TELEGRAMET DERGUAR KOMITETIT QENDROR  
TE PARTISE —

Si lumë vazhdojnë të vinë letrat dhe telegramet dërguar Komitetit Qendror të Partisë nga populli;

nga punëtorë e kooperativistë, gra e ushtarakë, të rinj e të reja, të mëdhenj e të vegjël, në të katër

anët e atdheut. Ata shprehin jo vetëm dhimbjen për këtë humbje të (Vijon në faqen 2)

### NE ZI FLAMURI, NE ZI ZEMRAT

Nuk qenë një vit e dy që populli e Partia i falën dashurinë më të zjarrtë Enverit tonë të shtrenjtë, Enverit, që s'mund ta besojmë se nuk është më. Është një gjysmë shekulli vetëm dashuri, vetëm mirënjohje. Një gjysmë shekulli edhe vëllai ta prish njëherë. Një gjysmë shekulli edhe në një familje do të kishte dikë që t'i mbetej qejfi. Po ç'fjalë i tha Enveri popullit dhe sheshet s'jehuan me parullën e pavdekshme «Parti-Enver, jemi gati kurdoherë!?!». Nën atë vuajtura i dhanë djemtë Komandantit të jepnin jetën për urdhrin, për këshillën, për fjalën e Tij, derdhën lotë kur morën mandatin, po i thanë me zemrën e nënës: «Të të kemi Ty, të kemi Partinë! Djalë mbi djem të kanë nënat shqiptare!». Një gjysmë shekulli mendja e Tij titanike gjeti zemrën dhe mendjen e popullit mbarë. Heroi i luftërave, i punëve madhështore, i mendimit dhe shkencës u nda, duke na lënë një dhimbje të rëndë. Shpatullat që mbajtën revolucionin, shpatullat që thyen bllokadat, s'e mbajtcan dot lart kryet sot.

#### Gajnë burrat si fëmijë, gajnë fëmijët si burra

Është dita e katërt e zisë kombëtare. Në zi flamuri, në zi zemrat e çdo patrioti e komunisti. Nënat e Labërisë ligjëruan fshatçet: «Ah, moj shkencë, gjëc belanë/ që s'gjete ilac të rrallë». Dhe janë nëna që rriten djem të një populli që kurrë s'i nëmi dijen e kulturën. Një nënë dënes e s'shkëputet dot nga arkivoli ku është vendosur trupi i shokut Enver. Dy djemtë që i ranë në luftë nuk i vajtoi dhe ndonjë lot për ta e fshehu. Është Hava Gjolliku.

— Enver, o djalë, ç'që kjo hata?! — thotë ajo dhe fillon e qan me ligje:

Ç'të zuri ki gjumë djalë, o djalë... Ngrehu, o trim se ke punë djalë, o djalë. I lidhur me shoqërinë djalë, o djalë. Të thuash ato që di djalë, o djalë. Kush tjetërë si Ti djalë, o djalë. Punoi për Shqipëri djalë, o djalë. I hodhe rrënjët Ti djalë, o djalë. Të keqen ku e more djalë, o djalë. Atë ditë që punove djalë, o djalë.

Ti më qaje mua hallë djalë, o djalë. Po sot më dhe shumë plagë djalë, o djalë.

Ku zë fill e ku mbaron ky varg njerëzish që u ra mbi supet dhimbja më e madhe e kohërave? Vij-në të ndahen, t'i japin lamtumirën e fundit njeriut më të shtrenjtë. Po askush s'do ta besojë që kjo është një ndarje e vërtetë. Ajo vetëm mund të ndjehet. E ndje-në zemrat, mendjet, «guri e dru-ri», siç tha ushtaraku Kozma Mo-ne.

— Kam qenë në punë edhe këto ditë, — na thotë shitësja e librarisë historike «Flora» Kimete Huqi. — Atë ditë që ra rrufeja, ja, këtu kam qenë, bashkë me sekretaren e Partisë. S'më zinte vendi vend. Më bë-hej se po kërcasin muret, se po lu-ajnë raftet. Unë jam komuniste, — shton pastaj me një ton më të ulët, — s'kam parandjenja e s'e them për gazetë, po atë ditë kanë rënkuar këto mure. S'më kanë bë-rë veshët, jo. Kur dëgjova radion, thashë: Dhimbje të madhe mbajt-kan këto trarë, si s'u rrëzuan...

Nuk është më në librari shitësi i dikurshëm. Malli do ta marrë këtë strehëzë ku formoheshin komunistët për Birin e saj të dashur, që e bëri monumentale, historike. Po ajo do të mbetet përjetësisht e nderuar, sepse përjetësisht do të bashkojë Enverin me popullin.

— Andej ndahen, — vazhdon Ki-metja, dhe lotët s'ia ndal dot ze-mra, — këtu vijnë e takohen. An-dej i japin besën e lamtumirën, këtu hyjnë kokulur e kërkojnë Veprat e Tij.

#### Enverit do t'ia dinë për nder brezat

«Si do t'ia bëjmë ne, nënëzestat, që do të na marrë malli, o Enver! Ngreu të keqen, ngreu!», — thotë një nënë tiranase, që këmbët s'i bëjnë të dalë nga salla e homa-zheve. Dhimbja është e thellë, por Enver Hoxha s'mund të ngrihet dot më. Po Ai është përjetësisht bashkë me popullin.

— Po shfletoja kalendarin e ta-volinës, — thotë Shpresa, studente. — 11 prilli — një fletë e bardhë. Në vitet e ardhshme do të shënohet si ditë e humbjes më të madhe. Po do ta ketë në anën e pasme gjithnjë atë shënim që kishte kë-të vit: «Njerëzit jetojnë në veprat e tyre». Vepra e shokut Enver mban në jetë një popull, një komb, një Atdhe...

Nuk janë, nuk janë ditë lamtu-mire këto ditë zie të përgjithsh-

me. Komunistët s'janë besimtarë, nga vdekja s'ka rikthim. Trupin e shokut Enver vërtet po e mbuloj-në lotët e një populli të tërë. Vij-në e harrohen me grushtin për-pjetë partizanë të vjetër, luftëta-rë të të njëjtave llogore, miq të shumtë të Tij, por s'e besojnë kurrsesi humbjen e madhe.

— Kur s'e prekën plumbat në Arbanë, që ia kam parë rreziqet me sytë e mi, — thotë 85-vjeçari Hysen Çeka, ish-partizan i çetës së Pezës, — më thosh zemra se ky nje-ri s'ka vdekte kurrë. Po ja, ç'e gjekta njeriun e s'e mbajtka!

Mbyte pikëllimin, o plak dhe mos beso se Ai vdiq! The se me shokun Enver u takove për herë të fundit kur vdiq Myslim Peza, por nuk u ndave për herë të fun-dit me Të as kur mbajtët mbi su-pe së bashku trupin e Babës, as sot! Shoku Enver nuk hyri në je-tën e popullit vetëm si Koman-dant, si Sekretar i Parë, po me emrin e një epoke. Ja, dëgjoje ç'tha një malësor nga Kukësi, që u ul në gjunjë në atë sallë pikë-llimi dhe s'lidhi veç dy fjalë:

— Babë, o babë!  
— Mendja më thotë mos qaj, mor bir, — na tha plaku më vonë, — po zemra s'e dëgjon mendjen. Se s'na bëri të huajin zot në shtëpi, se s'na la borxhe varë në qafë. Veç kush na ka! Enverit do t'ia dinë për nder brezat.

Dhe brezat kanë pjesën e vet në këtë dhimbje të madhe. Fëmijët që s'kanë lindur ende, nipërit e stërnipërit e tyre, do ta njohin 11 prillin dhe do t'u dhembë në zemër.

— Për vdekjen e Skënderbeut, përfytyroj një zi me përmasa të mëdha, — na thotë profesor Dhim-itër Shuteriqi. — Kanë kaluar 500 vjet. Dhe prapë, edhe studiuesi, me logjikën e ftohtë të shkencë-tarit, kur ndesh 17 janarin, tho-të: «Si nuk jetoj dhe ca!». Për Enverin do të thonë: «Si nuk je-toi deri në shekullin tonë!». Ku-rrë nuk do të ngopeshim, as ne, as brezat e ardhshëm, me Enverin!

Epokat do ta evokojnë emrin e shokut Enver, kohën e Tij, të ci-lën e bëri monumentale. Po monu-mentalë Ai bëri shqiptarët që je-tuan të njëjtën kohë me Të. Ësh-të një mirënjohje që do të përme-ndet në shekuj, që vërshon në kë-të sallë zije. Është mirënjohje, ë-shtë dashuri, nuk është dëshpë-rim. Prandaj është dhimbje kre-nare.

— Ne, brezi i ri, nuk i njohëm zi-në e bukës, zinë e urisë, zinë e (Vijon në faqen 2)



(Fotot: ATSH)



# DHIMBJE E NDERIM I PAKUFISHEM PER SHOKUN ENVER HOXHA

## NE ZI FLAMURI, NE ZI ZEMRAT

(Vijon nga faqja 1)

zhdukjes së fshatrave nga sëmudjet, - na thotë ish-gardisti Reiz Çela, - se i fshiu nga historia shoku Enver. Nuk e besonim, se do të na binte në dhembja e zisë më të rëndë. As tani nuk e besoj, tani që sa kam dalë nga homazhet. E nderova me grusht, siç e nderonim kur dilte të bënte shetitje, të glodhej, të na gëzonte ne me atë buzëqeshje. E nderova si ushtari Komandantin. Këmbët s'më lëviznin përpara. Ja, thashë me vete, tani do të lëvizë, do të ngrihet, do të më buzëqeshë e do të më thotë «Qetësohu!»

Komandanti i lavdishëm s'flet më dot. Ai, që vetë ishte urdhër i kohës, s'flet dot më të japë një komandë kaq të thjeshtë, të ngazëllezë zemrën e një të riu që derdh lotë, të glijorë një popull të tërë nga dhembja e jashtëzakonshme. Po Ai flet, i flet Partisë që vetë e krijoi, i flet ushtrisë që vetë e krijoi, i flet Atdheut dhe popullit, që s'i ndahen dot. Flet e burrëron breznitë.

Dhimbjen e rëndë nuk e zbut dot muzika funebre, që mbytet nga dënesat e vajet. Dallgë-dallgë, ato shpërthejnë krahavarësit dhe derdhen nëpër shkallë, koridore, rrugë. Vijnë me zemër të fortë, siç mësonet vetë shoku Enver, po gjëma e madhe të ligështon. Vijnë për të bërë roje ndëri e homazhe dhe përfaqësues të të gjitha rretheteve të vendit. Në një nga sallat e Presidiumit ata takohen e u sjellin ngushëllimet e popullit të rretheteve të tyre shokës Nexhmije Hoxha dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes. Vijnë ata që, në momentet më të vështira të jetës së vendit, në vitet e bllokadave dhe

tradhtive, hynin në shtëpinë e Tij pa trokitur, me opingat me gjalmë pa hequr, për të ndarë me të një hall të madh. Po sot zërit të dridhur nuk u përgjigjet dot Enveri! «Kaq ditë që po të ruajmë të na thuash një fjalë, o Enver, - nis e ligjëron një nënë di-brane». Vijnë e kuvendojnë me të shokët, bashkëluftëtarët, nxënësit.

Në një nga sallat e Presidiumit, një grup nxënësish e mësuesish takojnë dhe u shprehin ngushëllimet shokës Nexhmije Hoxha dhe pjesëtarëve të familjes së shokut Enver.

Duke i dhënë një buqetë me lule të freskëta shokës Nexhmije Hoxha, në emër të fëmijëve të të gjithë Shqipërisë, nxënësja Dasantila Alimërko i thotë: «T'ia çoni xhaxhit Enver. Humbja e tij është dhimbja më e madhe për gjithë fëmijët e Shqipërisë, ashtu si për Partinë e për popullin, për kombin tonë. Do t'i sjellim gjithmonë lule xhaxhit Enver e t'ia çoni në zyrën e Tij të punës, në atë zyrë në të cilën Ai mendoi e punoi kaq shumë edhe për ne fëmijët e Shqipërisë, për të gjithë fëmijët. I betohemi Partisë se gjithmonë me fjalët e tij në mendje e në zemër do të punojmë për të bërë realitet të gjitha ato dëshira, të gjitha ato mësimet që ai na dha. Me Partinë e me Enverin gjer në fund, nga Partia e Enveri asgjë s'na tunda».

Enveri kishte shumë shpresa për rininë. Dhe me të drejtë, që në fillim të luftës, gjatë gjithë kohës, - thotë shokja Nexhmije Hoxha.

Shqipërinë do ta mbajmë gjithnjë të kuqe, - betohet nxënësja në emër të të gjithë fëmijëve.

Një gjysmë shekulli e lartësoi me

dinjitet flamurin dora e Udhëheqësit. Që nga ai 28 Nëntori i 1944-ës, kur dora e Tij e shpalosi të lirë në Tiranë e lirë, ky flamur s'u tund. Dora që e ngriti, e mbrojti me vetëmohim. Asnjë shqiptar s'i ka dhënë aq nder e lavdi flamurit tonë, sa shoku Enver. Nuk i ndan vdekja Partinë, popullin, flamurin me shokun Enver, sepse nuk i ndan historia. Ajo i ka lidhur përjetësisht bashkë.

Le të jetë dita e sotme dita e fundit që Ai është midis nesh, le të shkojnë edhe vite e shekuj, këtë bashkim nuk e prekin dot kohërat. Një plak 95-vjeçar ka mbajtur shumë dhimbje e humbje mbi supet e këmbët s'e mbajnë të vijë në këtë sallë zije. Shikon në heshtje ekranin e televizorit, sheh trupin e shokut Enver, dhe i thotë djalit:

- Po folë, or bir, hidhet dhe mbi këtë mal?

Dhe inati me vdekjen s'ia mban më të fortë zemrën e regjurr:

Jo, mbi të do të ketë vetëm lule, vetëm mirënjohje, vetëm respekt e dashuri, prandaj nuk ka ndarje me të. Nuk mund të dalin zemrat nga gjokset. Historia lindi një Enver, por ajo lindi dhe miliona zemra, që mbajnë jetën, mendimin, Veprën e Tij. Popujt janë të pavdekshëm, të pavdekshëm janë edhe bijtë e Tij udhërrëfyes. Një gjysmë shekulli dashuri u mbush. Epoka të tëra do të jetojnë kjo dashuri. Ajo s'le ndarje, ajo vetëm bashkon. Përjetësisht bashkë...

PERPARIM XHIXHA  
SHABAN SINANI

Tiranë, 14 prill 1985

## GJIROKASTER

### Qajnë gurët, qajnë sokaqet

Në të gjithë qytetin dëgjohet një hap i ngadalë, i rëndë që sa vjen e afrohet në sheshin historik. Populli i Gjirokastrës, i qytetit që e lindi dhe e rriti shokun Enver Hoxha, mbledhet në miting dhimbjeje. Mitingje janë bërë gjithë këto ditë në Palorto e Manalat, Mashkullorë e Bodrishtë, Asim Zeneli e Li-bohovë, po prapë sot mbledhet e tërë Gjirokastra, që njerëzit t'i ndodhen njëri tjetrit, t'i japin forcë e kurajo, t'i premtojnë shokut Enver se tërë jetën do ecin në rrugën e Tij, sipas mësimëve të Tij.

Nuk deshmë - qan e thotë Tef-ta Angoni të vinim për këtë në këtë shesh, në sheshin e Çerçizit ku takoheshin tërë populli me të sahe-rë vinte në Gjirokastrë. Nuk deshmë.

Më i zi duket bronxi i statujës së Çerçiz Topullit, guri i busteve të Bules dhe Persefonit.

-Hë, ja ku më kini, na tha atë ditë të 17 marsit 1978. Edhe sot këtu e kemi, se zemër e Enver Hoxhës nuk pushon kurrë, thotë me fjalë burri Lilo Çali.

Vështirë është, shumë vështirë të shprehet me fjalë ajo çfarë ndjehet e duan të thonë njerëzit sot. Vetëm zemra i ka të gjitha. Të gjithë ata, si gjithë ky qytet, kanë kujtimet të shtrenjta e të paharruara nga takimet me shokun Enver. Ai i njihet, u fliste të gjithëve, i donte dhe i respektonte shumë. Edhe në momentet e punëve e hallëve më të vështira, shoku Enver e kujtonet Gjirokastrën për t'u çmallur, për të marrë forcë e frymëzim, për të punuar për Partinë e për popullin. Se

kur vinte këtu ripërtërihej. Kur u pranua në Parti Skënder Musti, në vitin 1942, në celulën e Tij ishte vetë shoku Enver.

- Nga vepra e shokut Enver, thotë, nga ato që ka shkruar, ç'ka folur e ç'na ka porositur, ne nuk do të luajmë. Komunistë të Enver Hoxhës do të jemi tërë jetën.

- Kam patur fatin të takohem e të bisedoj me shokun Enver si fëmija me prindin 23 vjet më parë, thotë pedagogu i matematikës, kandidati i shkencave Mite Guga. - Ke dëgjuar për Hamit Gugën? - më pyeti. Mua më zuri turpi. Më këshilloi të merresha me folklorin. Unë u mundova të zbatoj këshillën e tij dhe fillova të thurë vargje.

Më 1978 ai ngriti vargjet: «Te fura te hajsomeri/ Seç ia thotë këngësi Enveri». Këto ditë shkroi vargjet e ligjërit: «Mbylle sytë po na le dritë për çdo brez/ Biri i madh i kësaj toke, o Enver».

Gjimnazistja Albana Baboci mëson në klasën muze të shkollës së mesme të përgjithshme «Asim Zeneli» dhe rri në bangon ku ka mësuar shoku Enver. Klasa e dytë A është më e dalluara e shkollës.

-Kështu do të mësojmë përherë në brezi i ri i Shqipërisë, thotë Albana, që nga pionieret e organizatës «Pionierët e Enverit» deri tek studentët e Universitetit të Tiranës «Enver Hoxha». Notën 10 do të marrim edhe kur të dalim në jetë kudo që të punojmë në Shqipëri.

-Komiteti Qendror i Partisë na gëzoi me vendimin që mori mbremë që të ngrihet përmendorja e shokut Enver këtu në Gjirokastrë, thotë Shero Bakiri. Partia dhe po-

pulli do ta përjetësojnë figurën e shokut Enver. Vendi më të mirë, kreun e vendit do t'i zgjedhim këtu, që ta shikojë Gjirokastrën e ta shikojmë të tërë.

Këto i thotë nëna nënës, aneja anesë, vëllai vëllait. Këto i thotë Gjirokastra dhe Shqipëria mëmë birit të saj në këtoaste të rënda plumb. Trimi qahet, por Gjirokastra, Shqipëria, e gjen forcen tek Partia. Ish - partizani Myslim Zhaga thotë:

-Këtu në Gjirokastrë shoku Enver ka thënë se thesaret më të mëdha janë populli e Partia. Një thesar i madh i humbi popullit, por të rrojë Partia. Shokët e Komitetit Qendror i ka rritur dhe edukuar të gjithë një më një shoku Enver. Dje u betuam si në luftë. Dhe fjalja jonë atje, në atë betim që, Për Veprën e ndritur e të pavdekshme të shokut Enver Hoxha në shërbim të Partisë e të popullit, Vepër që do të rrojë në shekuj e do të frymëzojë të gjithë brezat për lulëzimin e mëtejshëm të Atdheut tonë socialist, foli sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Elmas Puto.

Përmes heshtjes, dhimbjes së madhe ndjehet i fortë dhe premtimi: «Enver do të qëndrojë siç deshe Ti, të gjithë popull e Partia».

Në hyrje të qytetit, pranë bustit të shokut Enver rrethuar nga lule shumëngjyrëshe të pranverës, punonjësit të qendrave të punës e prodhimit, kooperativistë, të rinj e të reja, ushtarakë, veteranë, pionierë etj. bënë homazhe dhe vendosën kurora dhe tufa me lule.

THANAS DINO

qytetet e Cërrikut e të Peqinit.

Të gjithë banorët e Kukësit të ri, qytetit të ngritur nga themelet në epokën e ndritur të Partisë, u mbledhën dje në një miting të përmortshëm për të nderuar me respekt të thellë Veprën dhe kujtimin e Udhëheqësit tonë të dashur shokut Enver Hoxha.

Për jetën dhe Veprën e birit dhe Udhëheqësit më të dashur të popullit tonë, shokut Enver Hoxha, që gjithë jetën ja kushtoi çështjes së madhe të revolucionit dhe socializmit, foli kryetari i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit, Rakip Balla.

Mitingje në nderim të jetës dhe veprës së udhëheqësit të dashur të Partisë dhe popullit tonë, shokut Enver Hoxha, u organizuan dje edhe në rrethe të tjerë të vendit.

(Sipas ATSH-së)

## VEPRA E SHOKUT ENVER ESHTË SKALITUR NE FLAMURIN E PARTISE, NE ZEMREN E POPULLIT

(Vijon nga faqja 1)

madhe, por dhe forcën e gatishmërinë për të ecur në rrugën e lavdishme të Partisë, në rrugën e socializmit, për t'i qëndruar besnikë në jetë të jetëve Veprës së pavdekshme të shokut Enver Hoxha.

Kurrë nuk do të harrojmë vizitën e shokut Enver në shtatorin e vitit 1967, shkruajnë në telegramin e tyre kooperativistët dhe populli i zonës së Reçit në rrethin e Shkodrës. Kurrë nuk do t'i harrojmë, thonë ata, bisedat gjatë me shokun Enver. Ai mbetet njeriu më i madh që ka nxjerrë historia e lavdishme e kombit tonë, Ai mbetet brez pas brezi i pavdekshëm.

Cilin prej nesh, shkruajnë studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit «Enver Hoxha» të Tiranës, nuk e ka bërë me krahë vlerësimi i lartë që shoku Enver u ka bërë shkencave. Kujt nga ne nuk i ka lënë mbresa të pashlyeshme logjika e hekurit e argumenteve të shokut Enver, kur ngulmonte se edhe popujt e vegjël kanë vend në diellin e shkencës. Mendimi shkencor i shokut Enver ka e do të ketë në shekuj ndikim të fuqishëm e vendimtar jo vetëm në përcaktimin e drejtimit të studimeve tona, por edhe në sukseset e arritura, në përvetësimin e dijeve e të shkencës bashkëkohore.

Illa Gazhga nga Bularati i Dropullit shkruan: Jam takuar disa herë me shokun Enver dhe gjithnjë më ka folur me dashuri e kujdes të veçantë. Jam plotësisht i verbër, por ngrohtësia dhe kujdesi i shokut Enver më kanë bërë të jetoj ditët e lumtura të Partisë që na solli edhe ne minoritarëve. Ndërsa nëna e dëshmorit Kristo Goga nga Sotira e Dropullit thotë: Nuk e harroj sa të jem gjallë takimin me shokun Enver kur Ai më përqafoi e më tha: «Si je moj trimëreshë Dropullite? Gëzohu se jetojmë ditë të lumtura» dhe shoku Enver shkoi mbi varrin e burrit tim dëshmor, ndëroi kujtimin e tij, u përkul përpara tij. Si mund t'i harroj unë këto? Emri dhe vepra e Tij janë futur thellë në zemrat e çdo Dropulliti.

Duke jetuar thellë këtë dhimbje të madhe edhe ne, shkruajnë komunistët dhe punonjësit e Kombinatit Poligrafik, betohemi se nën udhëheqjen e Partisë dhimbjen do ta kthejmë në forcë. Ashtu siç porosit shoku Enver në Përhëndetjen e Tij me rastin e 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut «do ta mbajmë lart e më lart flamurin tonë fitimtar, lart e më lart do ta ngremë nderin, prestigjin dhe emrin e Shqipërisë socialiste në botë». Këtë do ta materializojmë konkretisht në punën tonë, duke realizuar botime me cilësi dhe në kohë.

## POPULLI PER ENVERIN

Redaksisë së gazetës vazhdojnë t'i vijnë nga të gjitha anët qindra krijime, ku derdhet dhimbja e thellë e popullit për udhëheqësin e shqar shokun Enver Hoxha. Po vazhdojmë të botojmë edhe disa prej tyre.

### Karafilat e Drilonit

Oh ç'ishin ato fjalë plumbi  
Ç'dhimbje hodhi rrënjë në zemrën tonë  
Dalen, Mos u besoni fjalëve  
Shoku Enver është i gjallë, rron

Ejani të dalim buzë liqenit  
T'i stolisim rrugët për merak  
A s'e ndjeni se vera erdhi  
Dhe Enveri këtu do vijë prapë

Ejani të mbjellim karafila  
T'ja dhurojmë kur të vijë Enverit  
Buzëqeshja e Tij prapë do na ngrohë  
E në çast gjithë lulet do të çelin  
Ejani ta bëjmë lule Pogradecin  
Lule zjarri siç e donte Enveri  
Në Drilon prapë të çelë blerimi  
Rrezja të derdhet buzë liqenit

ANA KOVE

nxënëse në shkollën e mesme të bashkuar «Muharrem Çollaku», Pogradec

### Do gjëmosh si dallgë deti

Me dhimbje e lot u grumbulluan kooperativistët, të rinjtë, fëmijët dhe të moshuarit e Picarit e të Golemit malor. E vajtuan ata me ligje shokun Enver, ashtu siç dinë ta bëjnë këtë lehtë. Por ata dinë dhe dijnë të qëndronin edhe të fortë si shkëmbi, ta mposhtnin dhimbjen e ta kthejnë atë në forcë.

Nuk e prisim këtë gjëmë  
U drruh toka më në këmbë  
Do gjëmosh si dallgë deti  
Ashtu si ta kish adeti  
Na trondite më shumë se tërmeti  
Por Vepra përjetë të mbeti

Në këto momente të rënda hidhërimi, shkruajnë ushtarakët e Repartit N në Qytetin Stalin, betohemi se në unitet të çeliktë me Partinë dhe Komitetin e saj Qendror do të jemi në jetë të jetëve besnikë të Veprës së pavdekshme të shokut Enver Hoxha. Do të luftojmë kurdoherë me mësimet e Partisë e të shokut Enver në mendje e në zemër do të ngrihem në këmbë për të realizuar objektivat e vitit 1985, viti i fundit i pesëvjeçarit. Me punë e vigjilencë, nën udhëheqjen e Partisë do të rritim fitoret tona, do ta bëjmë jetën më të begatë.

Në këtoaste dhimbjeje të thellë, shkruajnë ushtarakët e Repartit N në Qytetin Stalin, betohemi se në unitet të çeliktë me Partinë dhe Komitetin e saj Qendror do të jemi në jetë të jetëve besnikë të Veprës së pavdekshme të shokut Enver Hoxha. Do të luftojmë kurdoherë me mësimet e Partisë e të shokut Enver në mendje e në zemër, do të forcojmë vazhdimisht gatishmërinë luftare dhe vigjilencën tonë revolucionare.

### Zemra jonë do të rrahë vetëm për Partinë

Zemra e shokut Enver pushoi së rrahuri por Vepra e Tij, mësimet e Tij rrojnë e do të rrojnë në shekuj, shkruajnë punonjësit e Agjencisë Telegrafike Shqiptare. Mësimet e shokut Enver, vënë në dukje ata, do të na prijnë në çdo hap të jetës sonë, grushtçeliku të bashkuar rreth Partisë. Zemra jonë do të rrahë vetëm për Partinë.

Mësimet dhe porositë shumë të vlefshme që ka dhënë shoku Enver gjatë vizitave të Tij në rrethin e Kukësit, shkruajnë në telegramin e tyre anëtarët e Këshillit të Frontit Demokratik të rrethit të Kukësit, janë dhe mbeten të freskëta. Në dritën e tyre, në dritën e mësimëve të Partisë, ne do t'i shtrëngojmë akoma më shumë radhët, do të çelikalim unitetin dhe do të rritim vigjilencën tonë revolucionare.

Të paharruara janë fjalimet programatike të shokut Enver për kinematografinë dhe bisedat e ngrohta me kineastët, gjatë xhirimeve, në festa apo përvjetorë, kur Ai na afrohej gjithnjë buzagaz dhe inte-

resohej për filmat, porosiste se ç'duhej xhiruar në të ardhmen dhe si duhej trajtuar ngjarja apo figura historike, si duhej ta jepnin të gjallë në ekran jetën dhe heroikën e popullit, shkruajnë punonjësit e Kinostudios «Shqipëria e Re». Shoku Enver, nënvizojnë ata, gëzohej një-lloj me ne, madje edhe me shumë, kur shikonte filmin e bukur shqiptar, veprën që, siç thoshte Ai, «reflektonte në vite e në shekuj». Betimi ynë solemn që del nga zemrat tona në këtoaste është: «Parti - Enver, jemi gati kurdoherë».

Ne, shkruajnë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Postave e Telekomunikacioneve, betohemi, ashtu si gjithë populli e Partia para Veprës së pavdekshme të shokut Enver, se do të jemi konsekuentë deri në fund me Partinë, me mësimet jetëdhënëse të shokut Enver. Do të bëjmë realitet dëshirën dhe porosinë e Tij për ta modernizuar ndërlidhjen, në përputhje me kërkesat e zhvillimit tonë politik, ekonomik, kulturor e shkencor.

### Vepra e shokut Enver do të na ndrisë ne dhe brezat që do të vijnë

Dhimbja, shkruan në telegramin e tij ekipazhi i anijes «Partizani» në lundrim, është shumë e madhe, por ashtu siç na mëson Partia, ashtu siç kërkonte shoku Enver, atë ne po e kthejmë në forcë për të realizuar detyrat. Në Veprat e shokut Enver, në mësimet e Tij ne kemi gjetur e do të gjejmë vazhdimisht frymëzim e orientim të përhershëm.

Idealin e shokut Enver Hoxha, shkruan populli i Lagjes Nr. 5 të Qytetit të Memaliajt, do ta kemi gjithmonë busull orientimi. Vepra e Tij do të na ndrisë ne dhe brezat që do të vijnë.

Mendimi filozofik, forca organizative dhe veprimtaria udhëheqëse e shokut Enver Hoxha, shkruajnë studentët dhe pedagogët e Shkollës së Lartë të Partisë «V. I. Lenin», kanë qenë dhe mbeten në themel të veprimtarisë së shkollës sonë. Vepra teorike e shokut Enver Hoxha është një kontribut i madh e i veçantë në zhvillimin e mendimit teorik marksist-leninist, që prek të gjitha çështjet e revolucionit e të ndërtimit të socializmit. Kjo Veprë, theksojnë ata, do të ketë gjithnjë vlerë të madhe ideore, me karakter kombëtar e ndërkombëtar.

Dhimbjen, shkruajnë komunistët dhe kooperativistët e kooperativës bujqësore «Çlirimi» në rrethin e Kolonjës, do ta kthejmë në forcë. Do të rritim mobilizimin tonë për të realizuar e tejkaluar detyrat e këtij viti, viti i fundit i pesëvjeçarit, do të shtrëngojmë radhët rreth Partisë dhe do të kalitim më tej vigjilencën tonë revolucionare.

(ATSH)

Foshnja e djepit thirri nanën.  
Ç'asht ai gjumë që nuk më zen?  
Çfar ka hana që nuk bjen?  
Qan krejt toka, qan dhe guri,  
Uli kokën dhe flamuri.  
Kërkojnë diellin që t'i ngrohi,  
Enver Hoxhën ma nuk shohin.  
Lëvroi zemrat e fshatit,  
Shkuli lotin çdo shqiptarit.  
Kush nuk qan për t'madhin emër  
Ishte zemër për çdo zemër!

FRROK HAXHIA

Pukë

### Ku po vete Enver Hoxha?

Sot të themi lamtumirë,  
I dashur, Enveri ynë  
S'na thotë zemra  
S'e thotë goja...

Ku po vete Enver Hoxha?!

FETAH BASHA

ushtarak

### Enver na dogje xhanë

Ç'që kjo gjëmë e paparë,  
Enver, na dogje xhanë!  
Jo, s'ke vdekur, je i gjallë,  
je në krye, je në ballë,  
je në Shqipërinë e bardhë.

MUSTAFA RUMANI

Tiranë



# MIRENJOHJA E MADHE E PARTISE DHE E POPULLIT

## GJITHE JETEN PER POPULLIN QE «E RUAJTI NEN GJUHE»

Këto ditë të rënda zie nëpër shtëpitë nga kaloi shoku Enver me Shtabin e Përgjithshëm, në kohën e vështirë të Operacionit të Dimrit, janë shtuar në mënyrë të veçantë hyrje-daljet e bashkëfshatarëve, shokëve të Partisë e të pushtetit aty, të afërmeve e miqve. U duket se kështu ia lehtësojnë pak më shumë edhe vetes edhe atyre dhimbjen. Hidhërimi e ka zbardhur krejt fytyrën e nënë Fanijes, gruas së Mitro Bodurit.

më mirë kohën. Kështu, përmes kësaj miqësie njerëzore e luftarake që lindi në atë ditë të vështirë që këta njerëz të varfër i përballuan bashkë me shokun Enver, filtrohet e del në krye mirënjohja e thellë për Udhëheqësin.

- Qeshë te goca kur e mora vesh atë fjalë të zezë. S'më rrihesh mua. M'u dukte se ma kishte fajin shpia. U ngrita e rashë poshtë. Edhe këtu

Enver Hoxha «Mes njerëzve të thjeshtë», bisedat, njerëzit ngjarjet që përshkruhen aty me aq dashuri e mall. - «Eli djalë im, - dëgjoja zërin e Ymer Cohës. Por mua nuk më mbylleshin sytë, - shkruan aty dora e shtrenjtë e Tij, - se e dija që në zemrën, në mendjen dhe në shpirtin e këtij fshatari të varfër heroik të Galigatit përplaseshin një mijë e një mendime, një mijë e një



Shoku Enver Hoxha gjatë një vizite në shtëpinë e File Musait.

rën e nënë Fanijes, gruas së Mitro Bodurit.

### «Na vrau pa plumb»

- Na vrau pa plumb, - thotë ajo e nuk përmbahet më, - iku shpejt, i ri.

Në mendjen e kësaj nëne, shoku Enver ka mbetur Ai i asaj mbrëmjeje të dimrit, kur erdhi në vatrën e tyre në Shëlcën, i ngrirë nga të ftohtit, i uritur. Shpirti i saj prej nëne ka regjistruar gjithçka të bukur që sollën vitet që erdhën më pas, ndërsa portretin e Tij e ka ruajtur të ri. Dashuria e nënës e fshin moshën.

- Edhe atëhere ta shofish, ç'bamë ne për Të e ç'bani Ai për ne? - thotë përmes lotëve Aishe Koci. - Erdhi me shokët këtu në kasollën tonë, natën vonë. Të dy të sëmurë ishim edhe unë, edhe Demi. Edhe fëmija sa na kishte lindë e mezi merrte frymë. S'na bëhej t'i bzajshim njëri-tjetrit. Erdhi Ai, s'e di shim kush asht, po kishte një fjalë e një gaz që na e treti terrin. Na dha edhe nga dy hapje e të nesërmen u gdhimë trëndafil. Ç'bamë ne për ta, i dhamë një copë bukë me qepë, Ai na e shëroi zemrën, na e mbush me shpresë. Kurrë s'i dalim borxhit, kurrë! Jo e jo ne që u plakëm, po as fëmijët tanë, as fëmijët e fëmijëve. Shoh veten tashi e them, më rehat Demi që nuk iu nxi zemra me një idhni si ky i sotmi.

- Jo, jo, - vazhdon nënë Aishja, nuk qemë ne që iu bëmë strehë Atij, na u bë Ai strehë ne, edhe në kasollet tona.

Dhe me këtë duan të thonë se Udhëheqësi ynë i madh, me atë që bëri për ta, duke biseduar rreth zjarrit, u bëri një nder të pamatshëm, ua çeli sytë për ta parë

gjeta plakën t'u qa. S'dijsha ku të futem, - thotë Mitro Boduri. - Nuk na harroi kurrë. E kishim e na kishte si të shpisë. Na gojte fjalë e i shkojshim për festa e për gëzime. Mine Peshku, e shoqja e komunistit Qazim Peshku, ka nxjerrë telegramin që i dërgoi shoku Enver asaj e fëmijëve më 25 shtator 1971, kur vdiq Qazimi.

- As një javë s'kishte kaluar, kur më erdhi lajmi për të shkuar në Tiranë. Ishim të gjithë ne, që e kishim pasë Enverin gjatë Luftës nëpër shtëpi. Na kishte lypur vetë Ai. Midis grumbullit më dalloj e m'u afrua. «Na la Qazimi», - më tha, të të rrojnë fëmijët». Të na rroni ju sa malet e Çermenikës e Partia, iu përgjigja. M'u duk se m'u ngjall Qazimi, me atë fjalë.

Nënë Tixhes, Hatixhe Ekmecijut në Elbasan, gjithkush i shkon këto ditë në shtëpi, ia bën edhe më të papërmbajtur dhimbjen e shpërthejnë lotët.

- Të keqen, pini nga një kafe, - na thotë me zë të dridhur. - Gjithë vitin do t'u kishte nxjerrë nana amëlsina, veç për 5 Maj e sot jo.

Asaj s'i bën zemra të flasë më tej, të thotë pse. Të koka e shtratit ka radion që ia ka dhuruar vetë Udhëheqësi, kur i erdhi për vizitë më 8 maj 1971.

- Tani vonë - thotë - ma çoi edhe librin «Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re». Ia kishte dhënë sekretarit të parë të ma sillte librin e të falat. M'i ka dërguar gjithnjë të më shohin edhe Nexhmijen, edhe fëmijët. Ua marrsha të keqen!

### Një mijë e një dëshira

Duke kaluar nëpër fshatrat e Çermenikës është e pamundur të heqësh nga mendja librin e shokut

dëshira e aspirata...».

«Një mijë e një dëshira e aspirata» realizoi për popullin Partia me në krye shokun Enver. Sadete Cohë, mbesa e Ymer Cohës, studente në fakultetin Histori-Filologji, tregon se qysh atëhere, në atë dimër të ashpër, Udhëheqësi i dashur projektonte të ardhmen e brezave që do të vinin. Kërkon të flasë më shumë, të premtojë, por lotët e dhimbjes nuk e lënë studenten e «Universitetit të Tiranës Enver Hoxha».

Në një vizitë tek familja e File Musait, vite më parë, shoku Enver pyeti: «Sa vjeç është kjo vajzë?» Njëmbëdhjetë i thanë. Kur të mbarosh shkollën, - i tha shoku Enver, Afërditës, vajzës së Kujtim Musait, në Elbasan do të jetë ngritur Metalurgjiku. Dhe Afërdita lajmën e hidhur e mori në Metalurgjikun «Çeliku i Partisë», ku këto ditë po kryen praktikën mësimore si inxhinieri kimiste. Ç'fjalë nxirrte ajo gojë e artë, ç'besim ngjallte tek populli!

Vetë nga vete fjala, po përsëri shkon tek ky prill!

Maliq Bozhiki, thotë: Për 40 vjet Enver Hoxha nuk la t'i ngulet një gjemb në këmbë Shqipërisë...

Musa Kallia: Amanet e kemi, o djema! Të mos kursejmë asgjë për këtë vend që aq shumë e dëshironte Enveri!

Gani Metoshi, Shmil: Vdekja e shokut Enver pikëlloi, çdo njeri, çdo familje, pikëlloi tokën. Edhe toka qan.

Liman Ruçi, Orenjë: Dhimbja është e madhe. Por zemrën ta mbajmë lart. Shoku Enver e la Shqipërinë si ajo molla plot kokrra.

BESNIK MUSTAJ  
NAIM ZOTO

## Enveri do të rrojë i gjallë si deti

Mbrëmë në hyrjen e madhe të portit detar u ndezën disa llampa të kuqe elektrike ku lexohet: «Porti detar i Durrësit Enver Hoxha». Ishte solemn ai çast kur në hyrje të portit u vendos emri i shokut Enver. Njerëzit qëndronin para saj dhe nuk largoheshin. Ç'po mendon vallë në këto caste Seit Jakupi?

- Na erdhi Enveri përsëri sonte e do ta kemi gjithmonë, ja, atje në ballë të portit tonë, shoku Enver do të jetë i gjallë si deti. Nxjerr nga xhepi një fotografi dhe vu lotët.

- Po punonim një 60 punëtorë në portin e ri, vazhdon. - Ishte viti 1960 atëhere. Këtu, ja këtu, të kalata e elektrovinçat, kishte vetëm zhavor, ca thasë me çimento e bitum që po e shtronim. Se si ktheva kokën pas. Kur ç'të shoh? Nga larg po vinte Ai, më këmbë, me trupin si lisi. «More Demir, iu drejtova një shoku, mos është Enveri Ai, apo më bëjnë sytë?». Ç'flet more, m'u përgjigj a Seferi, a Demiri, s'e mbaj mend mirë, ne s'dimë gjë, as një përgatitje nuk kemi bërë. Eh ç'përgatitje donte Enveri! Ne veç fshihim duar prapa se i kishim blazë. Ai vuri buzën në gaz e na zgjati duart. Ne u stepëm. Por Ai na tanoi duart dhe na përqafoi të gjithë.

ve. Siç ishim në këmbë, nën diellin e prillit (ishte një ditë prilli atëhere, po jo si ky prilli i hidhur plumb tani). Foli e foli gjatë me ne punëtorët e portit. Na pyeti për shëndetin, për familjet tona, për punën, për hallet, për kushtet e punës, për kërkesat që mund të kishim etj. Kur po bëhej gati të ndaheshim, i thamë: «Dua të bëjmë një fotografi bashkë, shoku Enver». «Më gjithë qejf, na tha, po më duket se nuk kemi fotograf». «Kam unë aparat», - u hodh një shoku ynë, dhe sa kaq iu afrua me aparat në dorë. «Shumë mirë, atëherë, hajdeni të dalim në fotografi, të kem një kujtim të bukur nga ju». Edhe sot të gjithë sa ishim aty e kemi këtë fotografi në shtëpitë tona. Kemi fotografinë, në shtëpitë tona, kemi edhe emrin e Tij në krye të portit, po e kemi vetë Enverin të gjallë në zemër.

Midis punëtorëve të portit erdhën dje anëtarë i Byrosë Politike të KQ të Partisë dhe sekretar i parë i Komitetit të Partisë të rrethit shoku Muho Asllani, ministri i Komunikacioneve Luan Babameto, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit, Ligor Çifliku, etj.

Në mitingun që u organizua me këtë rast, foli shoku Muho Asllani. Ai vuri në dukje vlerësimin e e madh që i bëri Partia dhe Komiteti i saj Qendror klasës punëtore të Durrësit duke i dhënë emrin e udhëheqësit të shtrenjtë të Partisë dhe të popullit tonë, shokut Enver Hoxha portit detar si qendër e madhe punëtore me tradita revolucionare. Dhënia e emrit Enver Hoxha; theksoi ai, shtron para të gjithë neve detyra për ta bërë portin tonë port pararojë të të gjithë vendit, pasqyrë të lulëzimit të të gjithë jetës sonë socialiste.

Pastaj e mori fjalën drejtori i ndërmarrjes Enfal Shagiri, i cili tha se komunistët dhe gjithë punonjësit e portit detar «Enver Hoxha» do të dijnë ta mbajnë lart e me nder këtë emër kaq të shtrenjtë e të dashur për të gjithë, se do të punojnë pa u lodhur për ta mbyllur planin e 7-të pesëvjeçar më 16 tetor, në 77-vjetorin e ditëlindjes së shokut Enver Hoxha. Në emër të shokëve të tyre folën punëtorët Shëf-çet Xibraku dhe Petraq Kazanxhiu.

Nga mitingu iu dërgua një telegram Komitetit Qendror të Partisë.

SOTIRAQ GJORDENI

## «MYZEQENE LULE NA E BERI KOMANDANTI»

Myzeqeja nuk do ta harrojë kurrë atë ditë, kur sapo mbushej viti i parë i Shqipërisë së lirë. Atë ditë myzeqarët e pritën Komandantin me krahë hapur dhe e kaluan gjoks me gjoks. Atje, në një tribunë të thjeshtë në Gorre, Enver Hoxha tha ato fjalë që kanë mbetur të skalitura: «... sot mbyllet një herë e mirë një fage e zezë dhe e trishtuar, plot vuajtje e mjerime, plot gjak e lot... dhe çelet një fag e re e lumtur, një fage ku dita-ditë shkruhen fitore».

Po mbushendy zot vjet dhe nga ata burra, që atëherë ishin 50 vjeçarë e që akom e ruajnë të nxeh të prush shtrëngimin e duarve. Komandantit ku u dha tapitë e para, sot e kanë vë shtirë ta mbajnë veten. Janë Laz Meqea e Joti Ziu.

- Eh, Komandant, o Komandant! - nis xha Lazja. E di, more bir që Enver Hoxha ka ardhur tri herë në Gorre? Sikur të qe në Lushnjë. Aman ore, sa fort na dëshil!

Erdhi të parën, na dha tapitë. U mblodhën këtu. Ka qenë një pyll. Të parit ia dha tapitë Ban Kolës. Atij që është në atë fotografinë me Komandantin. E ke parë ti? «Ta gëzosh tokën», - i tha. Të dytë Kristo Filit... Erdhi të dytën e na foli

për Tërbufin që thahej e për shkollat. Erdhi të tretën e vuri gurin te lapidari i Reformës. Vuri gur e mbajti fjalim. E deshëm si bir, e deshëm si Komandant. E deshëm si sytë. Nuk i tha kot në një rast Gor Basha: O Enver, bën pushime ti? Bëj, tha ai. Po ku i bën, e kishte pyetur Gori. Vete në Vlorë, në

- Dal në sallën e shoh një grup kalamajsh që qanin, - zë e flet Joti Ziu. Vjen dhe nipi më sytë e enjtur. Bledi, ç'ke? i them. Ai sheh e mezi përtyp: Ka vdekur xhaxhi... Nuk e vazhdoi më tutje. S'ia zinte goja emrin, s'ia mbante zemra gjë-mën. Këmbët m'u prenë. E si mund të harrohet kjo që na erdhi. Jo s'harrohet kurrë, se nuk harrohen veprat. Ato janë në ballë. E zëmë te tapitë, te Reformma. Po sa e sa u bënë të tëra emrin e Tij kanë.

Aman more, aman si ishim ne! Foli Lazja. Po ç'tu bënte 11 fëmijëve Lazja. 8 të tijtë, 2 të djalit që iu vra, një të motrës. Një Laze në një kasolle me një tra. Kërko të bëjë shtëpi Lazja e beu s'e linte. Partia me Enverin i shembu bejlerët. Është një fshat, e ke dëgjuar? E kush s'e ka dëgjuar! Stani i Bobos i thonë. I thoshin, thuj me mirë. Në pesë vjet gjithë fshatit u shua. Nga maljarja. M'u atje

ku sot është rezervuari i madh i Thanës, sa një liqen. Aman, more, ç'vepra të mëdha që ka bërë Partia me Enverin. Myzeqeja jonë është bërë lule. Lule Myzeqeja, lule Shqipëria.

HALIL LALAJ

### ELBASAN

## Gjithë jetën me Të në zemër

Në 1 Majin e vitit 1982, për 45 minuta rresht qëndrova krahëpërkrah me udhëheqësin e Partisë, shokun Enver, në tribunën qëndrore në Tiranë. Isha i gëzuar pa masë, por edhe mornica më kaluan në trup. Shoku Enver më pa me ngrohësi, më rroku në qafë më shtrëngoi fort dhe pastaj më pyeti: «Si të quajnë dhe ku punon?».

Të them të drejtën nuk di si iu përgjigja, ç'fjalë i thashë, por di që i kisha ngulur sytë dhe e shikoja me dashuri Udhëheqësin e Partisë. «Di ku jemi parë, Kristaq, një herë tjetër» më tha Ai. Dhe unë iu përgjigja: në Kongresin e 8-të të Partisë.

Ndërkaq kolonat e manifestuesve brohorisin «Parti-Enver». Bëra një hap prapa. U mundova që ta lija të lirë shokun Enver, kurse Ai më tha: «Afrohu, dil më përpara se je përfaqësues i klasës punëtore. Vendi ynë ka ecur shumë përpara, se ka një klasë punëtore të lavdishme», shtoi shoku Enver. Dhe unë i thashë (këtë e mbaj mend fare mirë se e kam përsëritur kushedi sa herë) se ka edhe një Parti të lavdishme dhe një Udhëheqës të shquar siç jeni ju shoku Enver. Më mori në gjoks dhe pastaj shtoi: Armiqtë na kanë halë në sy, Dhe unë iu përgjigja se ata

Pogradec... kishte thënë shoku Enver. A s'vjen t'i bësh në fshatin tonë? Bukë kemi, qumësht kemi, rrushet e fiqtë këtë vit kanë mbajtur mirë. Dhe Enver Hoxha e rroku në qafë Gor Bashën. Kështu e dëshoi Myzeqeja, djalë shkuar djalit.

ku sot është rezervuari i madh i Thanës, sa një liqen. Aman, more, ç'vepra të mëdha që ka bërë Partia me Enverin. Myzeqeja jonë është bërë lule. Lule Myzeqeja, lule Shqipëria.

### DIBER

## NA KA LANE DUARPLOT

Me tregue atë të shpirtit jam prekrejt. Mbramë në shtëpinë tonë nuk asht shtue sofra. Djemtë vunë vajin. U thashë: Mos qani. U la duarplot Enveri, u la Shqipërinë kala, ua pastroj udhën nga ferrat. Armiqtë u munduan boll, por Enver Hoxhën nuk e kapte plumbi, njjerë e pat ba nana për këtë popull. Kudo që të shkel kamba, kudo që të prek dora asht Enveri. Kur ndez dritën hy në odë - Ai, kur shtron sofrën ulet bashkë me ne në sofër, kur kërkon të drejtën - e ka thanë Enveri, kur kap pushkën bahesh trim si Enveri. Kalamajtë qajshin mbramë e unë bashkë me ta. I thashë djalit të madh tue pa mbramë televizorin: Hiqnje prej mendje se nuk asht ma Enveri. E kalamajtë e besojshin. E thojshin. «Po pse na gënjen ti babi, ja ku është xhaxhi Enveri, e shikon si flet».

Më tha një shoqi jem dje: «Ah bre Shukri, na thau krahët».

Ç'ka je tue thanë, i gjegja, na ka lanë duarplot, na ka lanë si çeliku. E ka qe Shqipërinë me qindra vjet përpara. Po po njashu asht po më thoshte ai shoqi jem. Njashu më thanë mbramë edhe kalamajtë. Ju fëmijët e mij, u thashë jeni fëmijët e Enverit, po të mos ishte Ai nuk kishit për me u ngopë me bukë.

SHUKRI TRUPIA  
Staravec, Diber

## IDEATOR I LETERSISE DHE ARTEVE TONA

Me dhimbjen e thellë të përgjithshme për humbjen e Udhëheqësit shkrihet dhimbja e shkrimtarëve, artistëve, e gjithë krijuesve tanë. Siç e thotë fjala poetike: Ky prill përjetoi atë që s'do ta përjetojnë qindra të tjerë. E pamësuar është gjuha për të formuluar mungesën e Atij që ka qenë i pranishëm midis nesh përherë dhe në gjithçka. Të pamësuar janë pena e shkrimtarit dhe mermeri i skulptorit. I papërgatitur është gjithë mendimi, gjithë përfytyrimi ynë.

Duke qenë ideator dhe arkitekt i Shqipërisë së re, Enver Hoxha është njëkohësisht i tillë edhe për shkencat, artet dhe letërsinë tonë. Mendja e Tij e gjerë prej ideologu, filozofi e eruditit të pashtershëm ka qenë një ndër faktorët kryesorë për të përcaktuar përmasat e themeleve të arteve e letërsisë së re shqipe, përmasa prej të cilave do të kushtëzohej pastaj shtati dhe lartësia e gjithë ngrëhënis.

Dhe kështu nën mësimet e Tij u

realizua një nga arritjet më të mrekullueshme të epokës: në vendin me kulturë mijëvjeçare, në dyzet vjet të epokës socialiste letërsia dhe artet tona arritën zhvillimin më të madh e më intensiv, të paparë ndonjëherë në historinë e qytetërimit të shqiptarëve.

Ai ishte mik i madh i shkrimtarëve e artistëve, me të cilët e bashkonin shumë gjëra. Duke qenë krijues i Partisë, i shtetit modern shqiptar, i gjithë levave dhe mekanizmave të sistemit të socializmit, Ai ishte njëkohësisht krijues veprash filozofike-letërsare të një vlere dhe bukurie të rrallë.

Ai e njihte letërsinë si askush tjetër, klasikën dhe të reën, shqiptaren dhe botëroren, që nga përrallat e moqme gjer tek veprat më moderne. Gëzohehim që lexonte aq shumë, por edhe kishim një preokupim: do ta lexojë ndoshta Ai, thoshim me vete sa herë që uletshim të shkruanin diçka dhe mendimi vetvetiu kërkonte thellësinë, fjala saktësinë dhe

peshën.

Ata shkrimtarë e artistë që e kanë pasur fatin ta njohin e të bisedojnë me Të, e kanë të paharruar në kujtesë, fuqinë pasionante, thellësinë, poliedrizmin, ngrohtësinë intime dhe njëkohësisht monumentalitetin e fjalës së Tij. Shembulli i fundit i kësaj ishte Përsëritja e paharruar që Ai i dërgoi popullitë gjithë kombit shqiptar disa muaj më parë në 40-vjetorin e Çlirimit. Tani, në sfondin e dhimbjes e të humbjes së Tij, ajo Përsëritje na ngjan si fjala e Tij e lamtumirës.

Por do të ketë lamtumirë me Enver Hoxhën. Populli në baladat e tij, pena e shkrimtarëve, pentagramet e muzikantëve, mermeri në studiot e skulptorëve, vetvetishëm do të synojnë drejt pamjes, figurës, mendimeve të Tij, për ta sjellë Atë përsëri midis nesh, ashtu siç ka qenë përherë, ashtu siç thuhet për të pavdekshmit: më të gjallë se gjithë të gjallët.

ISMAIL KADARE



# PARTI DHE PERSONALITETE SHTETERORE DHE POLITIKE TE BOTES VAZHDOJNE TE DERGOJNE NGUSHËLLIME ME RASTIN E VDEKJES SE SHOKUT ENVER HOXHA

Komiteti Qendror të Partisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shokut Ramiz Alia, Sekretar i Parë i KQ të PPSH-së e Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe shokut Adil Çarçani, Kryetar i Këshillit të Ministrave, vazhdojnë t'u vijnë telegra-

me nga parti, kryetarë shtetesh, kryeministra, organizata dhe personalitete të ndryshme politike e shoqërore, në të cilat shprehen ngushëllimet e sinqerta dhe ndjenjat e simpatisë me rastin e vdekjes së Udhëheqësit të Partisë e të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha.

## Vepra e shokut Enver Hoxha u shërben revolucionarëve të vërtetë dhe të shtypurve të të gjitha kontinenteve

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia në emër të komunistëve të Brazilit nga Zhaoa Amazona, shkruhet:

Të prekur thellë nga lajmi i hidhur i vdekjes së shokut Enver Hoxha, mik i madh i komunistëve dhe i popullit brazilian, ju lutemi me gjithë zemër t'i transmetoni Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe familjes së shokut Enver Hoxha ngushëllimet tona më të thella. Në këto çaste dhimbjeje që ka tronditur mbarë kombin tuaj i shprehim popullit shqiptar solidaritetin tonë vëllazëror dhe bashkohemi me dhimbjet që ai ndjen për humbjen e Udhëheqësit të tij të shquar.

Figura e pavdekshme e Enver Hoxhës është për shqiptarët simboli i Partisë Komuniste, që Ai e themeloi dhe e udhëhoqi deri në çastet e fundit të jetës së Tij, i çlirimit të atdheut të shkretuar nga hordhitë fashiste, është simboli i ndërtimit të socializmit, që e transformoi rrënjësisht pamjen e Shqipërisë dhe e ktheu atë në një vend përparimi, kulture, mirëqenieje për të gjithë bijtë e tij.

Jemi të vetëdijshëm për boshllëkun shumë të madh që krijon vdekja e Enver Hoxhës në radhët e proletarëve të të gjithë botës. Ai ishte luftëtar i madh, me largpamësi dhe me guximshëm për çështjen e çlirimit të punonjësve dhe të popujve të shtypur, luftëtar i palodhur për idealin e marksizëm-leninizmit. Kontributi i Tij në fushën e teorisë dhe të praktikës të ndërtimit fitimtar të socializmit është i paqumësht. Vepra e Tij u shërben revolucionarëve të vërtetë dhe të shtypurve të të gjitha kontinenteve.

Jemi të sigurtë se edhe tani që nuk e ka udhëheqjen e urtë të shokut Enver, populli shqiptar, luftëtar trim dhe i paepur për socializmin, duke pasur në krye bashkëpunëtorët e afërt dhe vazhduesit e vijës së Enver Hoxhës, do të gjejë forca për të kapërcyer çastet e vështira që po kalon dhe për ta çuar përpara flamurin e mbajtur lart prej Tij.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga Ramiz Alia, shkruhet:

## Luftëtar i madh internacionalist

Në telegramin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Zelandës së Re, shkruhet:

Me keqardhje të thellë mësuam për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Udhëheqësit të shquar të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar. Shoku Enver Hoxha luftoi për pavarësinë e Shqipërisë nga shfrytëzuesit imperialistë, duke e bashkuar gjithë popullin shqiptar për shpartallimin e pushtuesve fashistë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, për të shpartalluar sulmet e kapitalit botëror dhe të revizionizmit. Nën udhëheqjen e Tij populli shqiptar ka bërë përparime të mëdha në ndërtimin e socializmit. Si një mbrojtës i flaktë i marksizëm-leninizmit Ai u bë i njohur si udhëheqës i lëvizjes marksiste-leniniste ndërkombëtare.

Në telegramin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Punës të Francës, shkruhet:

Mësuam humbjen e shokut Enver Hoxha. Vdiq një udhëheqës i madh marksist-leninist. Gjithë komunistët në botë janë në zi. Në emër të komunistëve francezë përshëndesim kontributin e rëndësishëm teorik dhe praktik që i dha Ai klasës punëto- re, popullit shqiptar, Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare, proletarietit botëror në shërbim të revolucionit dhe socializmit, në mbrojtje të Marksizëm-Leninizmit. Ne përluemi me respekt para Tij dhe e sigurojmë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar për përkrahjen tonë vëllazërore.

Në telegramin e delegacionit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Indonezisë dhe të kryetarit

## Burrë i madh shteti, mishërim i shquar i vullnetit për pavarësi

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia nga presidenti i Republikës Algjeriane Demokratike Popullore, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë së Frontit të Çlirimit Kombëtar, Shadli Benxhedid, shkruhet:

Me dhimbje të thellë mësova lajmin e trishtuar të vdekjes së shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Me vdekjen e shokut Enver Hoxha, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë humbi një burrë të madh shteti, i cili gjatë gjithë jetës së Tij ka mishëruar në mënyrë shumë të shquar vullnetin për pavarësi, të lindur në luftën çlirimtare të pashoqe e shembullore të popullit shqiptar. Historia do të përfuturëjë veprën e Tij të madhe, të mençur dhe rolin e Tij të shquar në ndërtimin e një Shqipërie socialiste, moderne dhe të lulëzuar.

Në këto rrethana të dhimbshme, me lejonit t'ju shpreh në emër të popullit algjerian, të Partisë së Tij të Frontit të Çlirimit Kombëtar, të qeverisë së tij, si dhe në emrin tim personal ngushëllimet më të thella. të cilat, ju lutem, t'ia transmetoni popullit shqiptar dhe familjes së Tij.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga Mareshali i Republikës, kryetar i Partisë FRELIMO e president i Republikës Popullore të Mozambikut, Samora Moises Mashel, shkruhet:

Me emocion dhe hidhërim të thellë morëm lajmin e vdekjes së shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Shoku Enver Hoxha është për ne shembull i militantit që iu kushtua thellësisht idealeve të larta të lirisë dhe të demokracisë, është shembulli i luftëtarit antifashist konsekuent e të vendosur, i cili në frontet e ndryshme të luftës vinte të

## Udhëheqës që ngriti lart prestigjin e Shqipërisë në botë

Shokut Ramiz Alia i kanë ardhur edhe këto telegrame nga kryetarë shtetesh:

Në telegramin dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste Arabe Baath, president i Republikës Arabe të Sirisë, Hafez Al Asad, shkruhet:

Me hidhërim të madh mësuam për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në emër të popullit arab të Sirisë, të udhëheqësve të Partisë Socialiste Arabe Baath, si dhe në emrin tim, Ju shpreh Shkëlqesinë Suaj, Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, popullit shqiptar dhe familjes së shokut Enver Hoxha, ngushëllimet tona të sinqerta.

Në telegramin dërguar nga Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të OCP-së, kryekomandant i forcave të Revolucionit Palestinez, Jaser Arafat, shkruhet:

Përshëndetje revolucionare, Me trishtim dhe me dhimbje të thellë mësuam për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në emër të popullit arab palestinez, në emër të vëllazërve të mi, anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të Organizatës së Çlirimit të Palestinës, dhe në emrin tim personal, ju dërgoj Juve, Qeverisë dhe popullit shqiptar ngushëllimet e mia të sinqerta.

Populli ynë palestinez, nën udhëheqjen e OCP-së, nuk do t'i harrojë qëndrimet parimore të Udhëheqësit të madh Enver Hoxha në favor të luftës së drejtë të popullit palestinez për të rifituar të drejtat e tij kombëtare të pamohueshme. duke përfshirë të drejtën e tij të kthimit, të vetvendosjes dhe të ndërtimit të shtetit të tij kombëtar të pavarur në tokën e atdheut të vet.

Ju lutem, i dashur shok, t'u transmetoni familjes së Udhëheqësit si dhe Qeverisë Tuaj të respektuar, Partisë Suaj të madhe dhe popullit Tuaj mik përparim dhe lulëzim nën

gjitha forcat dhe energjitë e Tij për të mobilizuar popullin kundër tiranisë dhe shtypjes fashiste.

Ne admirojmë tek shoku Enver Hoxha veprimtarinë e Tij prej militanti revolucionar konsekuent në krye të grupeve të rezistencës dhe të komunistëve shqiptarë në kushtet e rënda dhe të vështira të luftës ilegale, duke zhvilluar një veprimtari politike, e cila ishte e një rëndësie të madhe në kuadrin e luftës për mbrojtjen e atdheut shqiptar.

Ne admirojmë tek shoku Enver Hoxha rolin vendimtar që luajti për themelimin e Partisë së Punës të Shqipërisë, duke e parë Partinë marksiste-leniniste si mjetin themelor të masave punonjëse shqiptare për triumfin e çështjes së demokracisë dhe të socializmit në atdheun e çliruar.

Në historinë e ndërtimit të socializmit në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, në udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, në fitoret e rëndësishme të arritura do të mbeten gjithnjë emri dhe kujtimi i pahuarar i shokut Enver Hoxha, i cili, në kushte jashtëzakonisht të vështira, udhëhoqi luftën e popullit shqiptar për mirëqenien, përparimin dhe lumturinë e tij, duke kontribuar me këtë për shtrirjen e kufijve të lirisë të popujve në luftën kundër imperializmit dhe për paqen botërore.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë FRELIMO, të Komisionit të Përhershëm të Asamblesë Popullore, të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Mozambikut dhe në emrin tim personal u shpreh Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, popullit dhe Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe familjes së Tij ngushëllimet tona më të thella.

Ndërmjet tona më të mira kujtimet të shokut Enver Hoxha. Lufta vazhdon.

udhëheqjen Tuaj të urtë. Revolucion deri në fitore.

Në telegramin dërguar nga Presidenti i Republikës së Bashkuar të Tanzanisë, Julius K. Nierere, shkruhet:

Me hidhërim dëgjua për vdekjen e Udhëheqësit të madh të Shqipërisë, Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha. Në emër të popullit, të Partisë Revolucionare të Tanzanisë dhe të Qeverisë së Republikës së Bashkuar të Tanzanisë, si dhe në emrin tim personal i dërgojmë gjithë popullit shqiptar, Partisë dhe Qeverisë së Tij, ngushëllimet tona të sinqerta.

Shoku Enver Hoxha ishte një patriot i madh dhe një komunist i vendosur, i cili e udhëhoqi vendin e tij për më tepër se 40 vjet.

Arritjet ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë i dedikohen shumë punës dhe udhëheqjes së Tij. Ai fitoi respektin për vete dhe ngriti lart prestigjin e vendit të vet. Shqipëria u bë me famë për pavarësinë e saj pa kompromis dhe për mbështetjen në forcat e veta. Në këtë mënyrë ai hodhi themelet e shëndoshë mbi të cilat Qeveria dhe populli shqiptar mund të zhvillojnë vendin e tyre dhe të bashkëpunojnë mbi bazën e barazisë me të gjithë ata që respektojnë sovranitetin dhe integritetin e tij kombëtar.

Ne në Tanzani, që prej një kohë të gjatë kemi marrëdhënie të përzemërta me Partinë dhe Qeverinë e Shqipërisë, në këto çaste hidhërimi dëshirojmë të shprehim simpatinë dhe solidaritetin tonë me të gjithë popullin shqiptar.

Ne kemi besimin e plotë se populli shqiptar edhe në të ardhmen nën udhëheqjen e vazhdueshme të Partisë së Tij do të shkojë duke u forcuar gjithmonë e më tepër, sipas shembullit dhe veprimtarisë që i dedikoi gjithë jetën e Tij shoku Enver Hoxha.

Ne shohim me bindje një miqësi dhe bashkëpunim të vazhdueshëm midis dy vendeve tona.

## Në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së nderohet kujtimi i shokut Enver Hoxha

Në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së e mbledhur më 12 prill 1985 për të shqyrtuar disa çështje të mbetura nga Sesioni i saj i 39-të duke hapur seancën plenare, kryetari i Asamblesë Pol Lusaka, theksoi se është detyra ime e hidhur të njoftoj me keqardhje për humbjen e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH dhe kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë Enver Hoxha.

Në emër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ai u shpreh Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe popullit shqiptar ngushëllimet e sinqer- ta. Në Asamble një numër përfaqësuesish të shteteve anëtare të OKB-së i shprehën delegacionit shqiptar ngushëllimet e sinqerta për vdekjen e udhëheqësit të shquar të Partisë e të popullit shqiptar shokut Enver Hoxha.

Në këtë seancë plenare e mori fjalën edhe përfaqësuesi i përherëshëm i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në OKB Justin Papajorgji, i cili foli për figurën e madhe historike të shokut Enver Hoxha dhe falenderoi kryetarin e Asamblesë si dhe përfaqësuesit e shteteve anëtare që shprehën ngushëllimet e rastit.

(ATSH)

## SHPALLET ZI KOMBETARE NE VIETNAM DHE NE BURKINA-FASO PER TE NDERUAR KUJTIMIN E SHOKUT ENVER HOXHA

TIRANË, 14 prill. - Agjencia vietnameze e lajmeve, VNA, njofton se Këshilli i Ministrave i Republikës Socialiste të Vietnamit shpalli Zi kombëtare për të nderuar kujtimin e shokut Enver Hoxha. Në një komunikatë, të botuar në gazetën kryesore të vendit, udhëzohen institucionet publike në mbarë vendin që më datat 15 dhe 16 prill të ngrënë flamurin kombëtar viet-

(ATSH)

## Ambasadori i RS të Vietnamit vendosi një kurorë pranë arkivolit të shokut Enver Hoxha në emër të Le Zuanit

Dje ambasadori i Republikës Socialiste të Vietnamit në vendin tonë Hoang Quoc Tin, vendosi një kurorë pranë arkivolit të Udhëheqësit të shquar të Partisë dhe të popullit

shqiptar shokut Enver Hoxha, në emër të shokut Le Zuan, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Vietnamit.

(ATSH)

## Ngushëllime nga miq e dashamirës të vendit tonë dhe bashkatdhetarë

Nga njoftimet e shumta që i kanë ardhur Agjencisë Telegrafike Shqiptare, vdekja e Udhëheqësit të madh e të dashur të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha, ka prekur zemrat e njerëzve përparimtarë kudo në botë, të miqve e dashamirësve të shumtë të vendit tonë, të shqiptarëve me banim jashtë Atdheut, të kosovarëve si dhe të arbëreshëve.

Erdha nga Bari në Romë, tha M. Arpana, që t'i shpreh popullit shqiptar ngushëllimet e mia. Jemi shumë të hidhëruar që humbëm edhe ne një udhëheqës të madh. Shoku Enver u përket revolucionarëve, proletarëve dhe popujve të botës. Arbëreshi Katapano vajti në ambasaden tonë në Romë dhe me sytë me lot tha: «Vdiq prijësi i prijësve ilirë, por Vepra e Tij do të ndriçojë si dielli».

Në telegramet e ardhura në përfaqësinë tonë në Ankara shprehet ngushëllimi dhe konsiderata e lartë për shokun Enver: «Enver Hoxhën e dëshëm si Ataturkun». «Ai do të mbetet i gjallë në zemrat tona», «Udhëheqës të mëdhenj si Enver Hoxha nuk vdesin, ata mbeten të gjallë në mendjet dhe në zemrat e popullit», «Jemi të bindur se brezi i tanishëm dhe të rinjtë e Shqipërisë që do të vijnë do të marrin dritë nga mësimet e Tij dhe do të ecin gjithmonë përpara».

Vëllezërit kosovarë nga SHBA, RF Gjermane, Austria, Suedia, Franca, etj., kanë shprehur me letra, telegrame dhe biseda telefonike dhimbjen e tyre të pakufishme për vdekjen e shokut Enver Hoxha. Një

nënë kosovare ka çuar një buqetë me lule me mbishkrimin: «Nga një nënë kosovare për birin e popullit shqiptar».

I prekur pamasë nga lajmi i vdekjes së udhëheqësit të Partisë dhe të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha, Nasi Papapano, shqiptar me banim në Rumani, thotë: «Ai i la traditë popullit shqiptar dhe historisë së tij dhe e mësoi si të rrojë i lirë, i pavarur, i papërkulur. Emri i tij do të mbetet i pahuaruar për gjithë brezat e ardhshëm».

«Me hidhërim të thellë mësuam lajmin e trishtueshëm jo vetëm për popullin shqiptar, por për tërë arbëreshët. Nuk do të shuhet vepra e kujtimi i tij as te shqiptarët, as te arbëreshët». Kjo ndjenjë përshkon telegramet e letrat e shumta, ngushëllimet dhe bisedat telefonike të arbëreshëve në Itali. Mario Albanesi u shpreh: «Kjo është një nga humbjet më të mëdha për popullin shqiptar, por edhe për komunistët kudo në botë». Burri i Shqipërisë nuk ka vdekur, ai rron dhe është me ne - me këto ndjenja u shpreh arbëreshi nga Kozenka L. Avjo.

Qytetarë të thjeshtë, punëtorë, miq e dashamirës të Shqipërisë kalojnë me lot në sy para fotovitrinave të përfaqësive tona diplomatike, ku janë vendosur portretet të shokut Enver. Të tjerë çojnë karafila të kuq për t'i vendosur tek portreti i shokut Enver me fjalët: «Me Enver Hoxhën në krye keni dhënë dhe po jepni një shembull të veçantë në botë».

(ATSH)

## KOLEGJUMI I REDAKSISE

### RADIO

E hënë, 15 prill 1985

10.00 Lidhje me shtetitorë «Dëshmorët e Kombit» dhe sheshin «Skënderbe», për transmetimin e mitingut të përmorshëm dhe ceremoninë e varrimit të shokut Enver Hoxha; 12.30 Muzikë simfonike; 13.00 Vargje për Partinë dhe shokun Enver Hoxha; 13.40 Muzikë simfonike; 14.00 Lajmet; 14.15 Muzikë simfonike; 14.40 Shoku Enver Hoxha për politikën e jashtme; 15.00 Muzikë simfonike; 15.30 Emisioni i lajmeve; 16.30 Muzikë simfonike; 17.00 Nga jeta dhe vepra e shokut Enver Hoxha; 17.50 Muzikë simfonike; 18.00 Lajmet; 18.10 Muzikë simfonike; 18.20 Shoku Enver Hoxha për zhvillimin e shkencës; 18.45 Muzikë simfonike; 19.00 Vargje për Partinë dhe

### TELEVIZION

09.55 Drejtpërdrejtë do të transmetohet mitingu i përmorshëm dhe varrimi i shokut Enver Hoxha; 18.00 Ritransmetim i mitingut të përmorshëm dhe i varrimit të shokut Enver Hoxha; 19.30 Vepra simfonike; 20.00 Ritransmetim i mitingut të përmorshëm dhe i varrimit të shokut Enver Hoxha; 21.30 Vepra simfonike; 22.00 Ritransmetim i mitingut të përmorshëm dhe i varrimit të shokut Enver Hoxha.